



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 223/1 Prot.

Tiranë, më 17.03.2022

V E N D I M

Nr.41, datë 17.03.2022

Mbi përfundimin e hetimit administrativ për vlerësimin e ligjshmërisë së aktit nr.2115/1, datë 11.11.2021, të Komisionit të Disiplinës të ISHPSHSH-së, për largim nga shërbimi civil të nëpunësit ***.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar; nenit 90/2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me pretendimet për mungesë të shkaqeve të ligjshme për zhvillimin e ecurisë disiplinore në ngarkim të nëpunësit *****,

Vërej se:

Nëpunësi ***** , nëpërmjet një kërkesë protokolluar me nr. 1088 prot., datë 16.12.2021, ka ngritur disa pretendime, për parregullsi në zhvillimin e procedurës për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, nëpërmjet dhënies së masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, mbi bazën e fakteve të paprovuara si dhe në shkelje të procedurës së kërkuar nga ligji. Ai, ka parashtruar se në seancën dëgjimore të zhvilluar për këtë procedurë, ka kundërshtuar me prova dhe fakte, çdo gjetje të pretenduar si shkelje në kryerjen e detyrave, por nga anëtarët e Komisionit Disiplinor këto prova nuk u morrën parasysh, duke çuar në këtë mënyrë në një vendimmarje të gabuar dhe paragjykuar, duke urdhëruar “Largim nga shërbimi civil”.

Për verifikimin e pretendimeve të mësipërme, u shqyrtua gjithë dokumentacioni shkresor i dërguar nga institucioni ISHPSHSH, nëpërmjet postës elektronike (*emailit zyrtar*), si dhe dokumentacioni bashkëlidhur kërkesës së nëpunësit, prej nga rezultoi e vërtetuar se nëpunësi ***** është nëpunës civil, pranë Drejtorisë Rajonale të Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Tiranë, Rajoni 1, me detyrë, “*Inspektor, në Sektorin e Inspektimit*”.

Ndaj tij, është zhvilluar një procedim disiplinor, i cili ka filluar me shkresën e eprorit direkt nr. 981 prot., datë 24.09.2021, “*Kërkesë për fillimin e ecurisë disiplinore*”, shoqëruar edhe me relacionin e datës 22.09.2021, në të cilin është parashtruar se në inspektimet që nëpunësi në fjalë ka kryer, nuk ka vepruar në përputhje me ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011, “*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*”; Ligjin nr. 9634, datë 30.10.2006, “*Për inspektimin e punës*”, i ndryshuar; si dhe Urdhërin nr. 25, datë 10.08.2018, “*Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ”*”.

Shkeljet e evidentuara, eprori direkt i ka cilësuar si, “*mospërbushje e detyrave*”, që në kuptim të nenit 57, pika 3, shkronja “*a*”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, klasifikohet si *shkelje e rëndë disiplinore* dhe për këtë arsye, në bazë të pikës 2 të nenit 59 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, i ka kërkuar Komisionit Disiplinor si organi kompetent, fillimin e procedimit disiplinor për nëpunësin *****.

Mbi këtë bazë, Kryeinspektori i ISHPSHSH, me aktin nr. 2113/2 prot., datë 24.09.2021, ka vendosur fillimin e ecurisë disiplinore ndaj nëpunësit ***** dhe e ka përcjelljë çështjen për shqyrtim pranë Komisionit Disiplinor.

Me Urdhërin nr. 325, datë 24.09.2021, të Kryeinspektorit, “*Për krijimin e Komisionit Disiplinor*”, është ngritur Komisioni Disiplinor, përbërja e të cilit rezulton në përputhje me pikën 2, Kreu I, “*Organet disiplinore*”, të Vendimit nr. 115, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil*”, të ndryshuar. (Kryeinspektori i ISHPSHSH-së, në cilësinë e nëpunësit më të lartë civil të institucionit (kryetar i komisionit); Kryeinspektori i Drejtorisë Rajonale të ISHPSHSH-së, Tiranë, Rajoni 1, në cilësinë e eprorit direkt (anëtar); Drejtore e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, përfaqësuesja e njësisë së burimeve njerëzore (anëtar); nëpunësi më i vjetër civil i institucionit (anëtar), si dhe një përfaqësues i Departamentit të Administratës Publike).

Me aktin nr. 2113/1 prot., datë 24.09.2021, “*Njoftim për procedimin disiplinor*”, nëpunësi *në fjalë*, është njoftuar për fillimin e ecurisë disiplinore, si dhe për shkaqet e nisjes së kësaj ecurie disiplinore; për të drejtën e tij për të paraqitur me shkrim, sqarimet rreth

shkeljes së pretenduar; për të drejtën për t'u dëgjuar vetë ose me përfaqësues; si dhe datën e shqyrtimit të shkeljes së pretenduar.

Në lidhje me shkaqet e nisjes së ecurisë disiplinore, ato janë përmbledhur e renditur nga ana e eprorit direkt, duke shërbyer si bazë për zhvillimin e ecurisë nga ana e Komisionit të Disiplinës, si më poshtë:

- *Ka mbyllur procesin e inspektimit për mos realizim inspektimi, por ndërkohë në sistem nuk ka ngarkuar asnjë dokument që të vërtetojë se subjekti nuk ushtron aktivitet. (çështjet TR-2021-001844; TR-2021-000807)*
- *Mungon autorizimi i timbruar nga subjekti (gjithë dokumentacioni i administruar në dosjen e inspektimit, i nënshkruar edhe nga subjekti dhe i ngarkuar në portal në dosjen përkatëse. (çështja TR-2021-001843)*
- *Mungon ankesa në portal dhe kthimi i përgjigjes së ankuesit (çështja TR-2021-001653).*
- *Vendimi në portalin e ndërgjegjësimit është mbyllur mbrapa vendimit në portal, gjë që do të thotë se inspektori nuk është këshilluar me portalin e ndërgjegjësimit (Matricën e Dënimeve) sipas rregullave të përcaktuara në manualin përdorues të kësaj platforme (çështjet TR-2021-001452; TR-2021-001216; TR-2021-000810; TR-2021-000805; TR-2021-000431; TR-2021-001452).*
- *Mungojnë dokumenta justifikues të subjektit të cilat duhet të ishin hedhur në sistem si: dokumenti i riskut, kontrata individuale e punës, kontrata me mjekun e punës (çështjet TR-2021-000809; TR-2021-000806; TR-2021-001450; TR-2021-001446)*
- *Ka kryer inspektimin në zyrën kryesore të subjektit ku ka qenë vetëm 1 (një) i punësuar, ndërkohë që në listën e verifikimit ka hedhur të dhëna për 155 të punësuar për të cilët nuk ka kryer kontroll fizik. (TR-2021-001445) etj.*

Në përmbledhje të tyre, duke u shprehur për vlerësimin e rëndësisë së shkeljeve të pretenduara, shkeljet e renditura si më sipër janë përcaktuar sipas pikës 2, të nenit 57, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si “**shkelje të rënda**”.

Seanca dëgjimore për të shqyrtuar shkeljet e pretenduara ndaj nëpunësit në fjalë, është zhvilluar në datën 15.10.2021, në ambientet e institucionit, me përbërjen e rregullt të Komisionit të Disiplinës dhe pjesëmarrjen e palëve (pas 1 shtyrje, për shkak se u paraqitën shtesa e sqarime për të cilat nëpunësi i proceduar nuk ishte në dijeni dhe për ti dhënë kohën e duhur nëpunësit të njihet me materialin, si dhe të përgatisë mbrojtjen e tij).

Komisioni Disiplinor, në vendimin e vet arsyeton se pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e administruar në dosjen disiplinore të nëpunësit *****, si dhe provat e paraqitura nga palët, në përfundim të hetimit administrativ, arriti në konkluzionin

se nëpunësi në fjalë, i ka kryer shkeljet e pretenduara duke mos përmbushur në këtë mënyrë detyrat funksionale, sanksionuar nga legjislacioni i punës, të cilat në kuptim të nenit 57, pika 2, shkronjat “a” dhe “c”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, klasifikohen në **shkelje shumë të rënda disiplinore**.

Në përfundim të shqyrtimit të shkeljeve disiplinore të pretenduara, duke mbajtur parasysh edhe dy masa të mëparshme disiplinore, “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen e shkallës së pagës për një periudhë 12 mujore”, dhënë nga Komisioni Disiplinor me vendimin nr. 1665/8, datë 18.09.2020, si dhe masën disiplinore, “Vërejtje”, dhënë nga eprori direkt, me vendimin nr. 202/5, datë 02.04.2021, Komisioni Disiplinor, me vendimin nr. 2115/1, datë 11.11.2021, ka vendosur marrjen e masës disiplinore, “Largim nga shërbimi civil”, me motivacionin, “mospërmbushja e detyrave”, si dhe “moszbatimi haptazi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale”, për nëpunësin *****₂, duke renditur në përmbajtjen e tij shkaqet dhe rrethanat, të parashtruara si më sipër nga ana e eprorit direkt.

Mbi bazën e vendimit të mësipërm të Komisionit Disiplinor, me Urdhërin 365, datë 12.11.2021, të Kryeinspektorit, është vendosur ndërprerja e marrëdhënies financiare për nëpunësin në fjalë.

Nëpunësi *****₂, në parashtresën e tij i ka kundërshtuar pretendimet e mësipërme, duke arsyetuar se shkeljet disiplinore që i atribuohen nuk qëndrojnë. Në veprimet dhe mosveprimet e tij, thekson nëpunësi, nuk vërehen shkelje të një rëndësie apo natyre të tillë që të mbështesin nisjen e ecurisë disiplinore për shkelje të rënda disiplinore. Pasaktësitë e ndryshme të vërejtura, janë shoqëruese të kryerjes së detyrës në përgjithësi dhe lidhen me natyrën e punës, prandaj nuk mund të mbidhen me tendencë dhe të kualifikohen si në kuptim të nenit 57, pika 1, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe, ka kërkuar që Komisioni Disiplinor, të vendosi mosmarrjen e ndonjë mase disiplinore, për mungesë të fakteve që do të përbënin shkelje disiplinore nga ana e tij.

Në gjithë veprimtarinë administrative si më sipër, të kryer gjatë zhvillimit të kësaj ecurie disiplinore, vërehen disa pasaktësi të dukshme, në kuptimin e menaxhimit të drejtë nga pikpamja e shërbimit civil.

Konkretisht, ecuria disiplinore nga ana e eprorit direkt, është kërkuar të fillojë për “shkelje të rënda”, të cilat parashikohen nga pika 3, e nenit 57, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kërkesë e cila është shoqëruar me të njejtin kualifikim nga ana e drejtuesit rajonal të ISHPSHSH.

Për “shkelje të rënda”, ka nisur edhe shqyrtimi disiplinor nga ana e Komisionit të Disiplinës dhe vetëm pasi ka filluar seanca e dëgjimit të pretendimeve të palëve, është

parashtruar nga ana e eprorit direkt, se kishte edhe disa shkelje të tjera disiplinore, të cilat duhej të bashkoheshin me shkeljet e parashtruara më parë e të merreshin në shqyrtim nga ana e Komisionit Disiplinor, duke i kualifikuar ato s përfundimisht, si “shkelje shumë të rënda”.

Lejimi i një veprimi të tillë nga ana e Komisionit të Disiplinës, në një kohë që kishte filluar shqyrtimi i ecurisë disiplinore, është një vënie e nëpunësit përpara një situatë të padrejtë, në drejtim të rëndimit të pozitës së tij.

Në këtë rast janë shkelur parimet e drejtësisë, proporcionalitetit dhe objektivitetit, parashikuar nga nenet 12, 13 e 14, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrativ i RSH”, sipas të cilëve, organi publik në ushtrimin e funksioneve të tij trajton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, të gjitha subjektet me të cilat krijon marrëdhënie dhe se gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, ato duhet të marrin në konsideratë dhe ti japin rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave, që lidhen me procedurën administrative. Kështu, Komisioni i Disiplinës, e ka vënë në pozita të disfavorshme nëpunësin e proceduar, kur ka pranuar kërkesën e eprorit direkt për shtimin e disa “shkeljeve” të tjera dhe rikualifikimin e shkeljes disiplinore, nga “shkelje të rënda” në “shkelje shumë të rënda”.

Ky veprim i eprorit direkt, është i parregullt nga pikpamja e administrimit të shërbimit civil. Për të nuk kishte asnjë pengesë të tregonte kujdesin e duhur, për të evidentuar gjithë shkeljet e nëpunësit *****, e mbi këtë bazë të bënte kualifikimin e duhur të shkeljes disiplinore, përpara se të bënte kërkesën për fillimin e ecurisë disiplinore.

Për më tepër, nga shqyrtimi në përmbajtjen e tyre, të “fakteve të reja”, që u paraqitën para Komisionit Disiplinor dhe shërbyen për ti quajtur shkeljet e rënda, në shkelje shumë të rënda, ishin po ato që ishin parashtruar më parë, vetëm se tani ishin zbërthyer më hollësisht dhe ishin shtuar pak raste të tjera të të njejtës natyrë, të ndodhura më parë se të fillonte ecuria disiplinore.

Sipas kuptimit që i jep legjislacioni i shërbimit civil, shkeljes disiplinore dhe procedimit disiplinor, për “shkelje të rënda” nuk ka rëndësi numri i shkeljeve, për ti klasifikuar ato “shkelje shumë të rënda”, por lloji i shkeljes, ose në një farë mënyre “cilësia” e këtyre shkeljeve. Vetëm në rast se shkelja disiplinore është e llojit shumë të rëndë, siç renditen ato, në pikën 2, të nenit 57, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, atëhere procedimi duhet të fillojë e të përfundojë për shkelje shumë të rënda.

Konstatohet gjithashtu se, Komisioni i Disiplinës, gjatë kryerjes së detyrës, nuk ka mbajtur parasysh si duhet, parimin e dhënies së ndihmës aktive, në mënyrë të barabartë për të dy palët, por duke favorizuar eprorin direkt dhe drejtuesin e institucionit, e ka ndryshuar

kualifikimin e procedimit disiplinor, duke vënë në pozitë të disfavorshme nëpunësin e proceduar. Kjo duket jo vetëm në faktin që është pranuar kërkesa e tyre për rëndimin e natyrës së shkeljeve nga ana e nëpunësit, por veç kësaj, është trajtuar si rrethanë rënduese për të, masa disiplinore *“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen e shkallës së pagës për një periudhë 12 mujore”*, dhënë më parë nga Komisioni Disiplinor me vendimin nr. 1665/8, datë 18.09.2020, e që në momentin e daljes së vendimit të fundit, ishte **e kryer** si ndëshkim disiplinor.

Nga ana tjetër, duhet thënë gjithashtu, se shkeljet e renditura si shkaqe për zhvillimin e ecurisë disiplinore, janë të natyrës që mund të ndikohen edhe nga mungesa kualifikimit të duhur të nëpunësit, nga moskuptimi si duhet i detyrës për këtë shkak, nga mungesa e ndihmës dhe kontrollit të nevojshëm nga ana e drejtuesve gjatë kryerjes së detyrës e sidomos nga mungesa e përpjekjeve dhe veprimeve të këtyre të fundit, që nëpunësi të mos lejohej të thellohej më tej në gabimet e tij.

Pra, si përfundim, duhet thënë që masa disiplinore e dhënë ndaj nëpunësit ***** , për *“largim nga shërbimi civil”*, është një veprim administrativ i cili ka elementë të mjaftueshëm paligjshmërie të cilat, po të ishin mbajtur në konsideratë, do të bënin që Komisioni i Disiplinës, të arrinte në një përfundim më të drejtë, duke dhënë një masë disiplinore, më të përshtatshme me natyrën e shkeljeve të pretenduara.

Megjithatë, gjatë zhvillimit të këtij hetimi administrativ, është konstatuar edhe një rrethane e re, që nëpunësi në fjalë i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, me kërkesë padi me objekt shfuqizimin e aktit administrativ nr. 2115/1, datë 11.11.2021, të Komisionit të Disiplinës të ISHPSHSH, për dhënien e masës disiplinore, *“Largim nga shërbimi civil”*, si dhe aktit nr. 365, datë 12.11.2021, të Kryeinspektorit, *“Për ndërprerja e marrëdhënies financiare”*, çështje e cila është në shqyrtim, prandaj shkeljet e mësipërme të kryera/lejuara gjatë procedimit, evidentohen si momente të një administrimi të parregullt, të shërbimit civil.

Ndodhur në këto rrethana, bazuar në paragrafin e tretë të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit *“Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata”*, duhet të vendoset përfundimi i hetimit administrativ, pasi mosmarrëveshja do të zgjidhet përfundimisht nga gjykata, e cila do të vendosë edhe për zgjidhjen e pasojave të aktit.

Por, ndërkaq duhet theksuar edhe një herë që njësia e burimeve njerëzore e institucionit ISHPSHSH dhe aktorët e tjerë pjesëmarrës në këtë proces administrativ, të mbajnë parasysh shkeljet e evidentuara në menaxhimin e këtij rasti, në mënyrë që në të ardhmen, të mos përsëriten paragullsitë e lejuara/kryera në këtë procedim disiplinor.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; bazuar në nenin 90, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ filluar në bazë të informacionit të regjistruar me nr. 1088 prot., datë 16.12.2021, në lidhje me largimin nga shërbimi civil të nëpunësit ***** , për shkak të dhënies së masës disiplinore dhe arkivimin e çështjes, pasi rasti është duke u shqyrtuar nga Gjykata.
2. Të njoftohet për këtë vendim ISHPSHSH, DAP dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha